



## KOMUNA E PRISHTINËS

### RAPORT

Drejtoria	<b>Drejtoria e Shëndetësisë</b>
Periudha Raportuese	<b>Dhjetor, 2021</b>
Përmes	Muhamet Pervetica, udhëheqës i Sektorit të shëndetësisë, DSH
Raportuesi	Dr. Fatlinda Hoxha, zyrtare për shëndetësi, DSH

#### 1. PËRMBLEDHJE

Përmbledhje e përgjithshme rreth mbarëvajtjes/ecurisë së punës në drejtorinë tuaj për muajin raportues.

Gjatë muajit dhjetor 2021, Drejtoria e Shëndetësisë pranoi 9 lëndë, prej të cilave 8 lëndë i përkisnin kategorisë së subvencioneve mjekësore, ndërsa 1 prej tyre ishte e kategorive të ndryshme. Stafi i drejtorisë kishte takime të përditshme me qytetarë, për t'u njoftuar me procedura dhe shërbime sipas interesit dhe kërkesave të tyre.

#### 2. AKTIVITETET E PLANIFIKUARA

Listoni aktivitetet për muajin raportues të parapara me planprogramin e Komunës për drejtorinë tuaj:

- Furnizime të ndryshme bazuar në kontratat aktive;
- Monitorimi i mbarëvajtjes së punës në përditshmëri të personelit shëndetësor në QKMF dhe njësitë e saj, si dhe në QMU;

- Inicimi i përgatitjeve administrative, zbatimi i planit të prokurimit 2021;
- Përpilimi i raporteve të ndryshme në kuadër të Drejtorisë.

### 3. AKTIVITETET E IMPLEMENTUARA

Listoni dhe shpjegoni aktivitetet e implementuara gjatë periudhës raportuese nga drejtoria juaj, duke përfshirë edhe aktivitetet që janë në implementim e sipër. Theksoni të arriturat e Drejtorisë:

- Përpilohet projektdokumenti “Plani i veprimit 2022”;
- Pjesëmarrje në:
  - o Trajnim - Fuqizimi i punëtorëve socialë për të ofruar shërbime sociale personave LGBTI;
- Përpilim të dhënash në pyetësin dërguar nga UN Habitat – Ndikimi COVID 19 në komunat e Kosovës;
- Përgatitje mbi zbatimin e Planit të Prokurimit 2022;
- Gjatë periudhës raportuese, situata me pandeminë ishin 140 raste aktive;
- 29 qytetarë pajisjen me vërtetime për COVID 19;
- Kujdesi parësor shëndetësor fillon me procesin e vaksinimit si përgjegjësi vetanake, më 20.12.2021. Fillimisht kemi punuar me 7 ekiye, për të vazhduar me 9 ekiye profesionale. Përderisa 1 ekip profesional – vaksinimi është dërguar edhe në qendrën tregtare “Albi Mall” për kohën 12- 20 ekip tjetër, varësisht nga orari dërgohet 3 herë në javë edhe në Aeroportin “Adem Jashari”. Gjithashtu, vaksinimi është realizuar edhe në institucionet fetare dhe sheshet e Prishtinës, bazuar në kërkesën e Komitetit për imunizim.
- Nga data 20.12.2021, janë administruar 3,671 doza të vaksinave. Numri total i dozave të administruara në Komunën e Prishtinës deri më ditën e raportimit është 261807.

### 4. AKTIVITETET NË IMPLEMENTIM E SIPËR

Të përshkruhen në detaje aktivitetet që janë në implementim e sipër nga drejtoria juaj për muajin raportues:

- Përgatitje rreth përpilimit të planit të prokurimi 2022;
- Mbikëqyrje e vazhdueshme e punës së përditshme të personelit shëndetësor në objektet shëndetësore rreth mbarëvajtjes së punës;
- Përgatitje teknike për vlerësimin e lëndëve rreth subvencioneve – shëndetësore.

## **5. STATISTIKAT**

Të listohen të gjitha statistikat përkatëse për drejtorinë tuaj, duke filluar nga buxheti i planifikuar dhe ai i shpenzuar për periudhën raportuese, diskutimet publike, takimet me palë, institucione, qytetarë e të ngjashme, kërkesat për qasje në dokumente zyrtare, lëndët e pranuar, të kryera dhe në përfundim e sipër, dhe statistika të tjera specifike që mund të ketë drejtoria juaj. Shtoni kategoritë sipas nevojës.

**5.1.1.** Buxheti i planifikuar dhe ai i shpenzuar për periudhën raportuese.

**5.1.2. Takimet me palë**

- Çdo ditë nga 9:00-15:00, DSH bën pranimin e palëve.

**5.1.3. Takimet me institucione të tjera**

- Drejtoria e Prokurimit:
  - o Procedura rreth kontratave të ndryshme;

**5.1.4. Diskutime publike / takimet me qytetarë**

**5.1.5. Kërkesat për qasje në dokumente zyrtare**

**5.1.6. Lëndët e pranuar, të kryera dhe në përfundim e sipër**

Gjatë muajit dhjetor 2021, Drejtoria e Shëndetësisë pranoi 9 lëndë, prej të cilave 8 lëndë ishin për kategorinë e subvencioneve mjekësore, ndërsa 1 prej tyre ishte e kategorive të ndryshme.

**5.1.7 Përfitues të subvencioneve:**

**5.1.8. Takime të tjera**

## **6. SFIDAT**

Nëse gjatë implementimit të planeve është hasur në vështirësi të ndryshme, p.sh. pengesa brenda drejtorisë, Komunës apo institucioneve të ndryshme, ju lutem shpjegoni në këtë hapësirë.

- Mungesa e stafit në DSH;

- Numri i jo i mjaftueshëm i stafit shëndetësor, bazuar në nevoja të qytetarëve;
- Buxhet jo i mjaftueshëm, sidomos për kategorinë “Mallra dhe shërbime”, ku me rritjen e numrit të pacientëve dhe shërbimeve, rrezikojmë shërbimet e vazhdueshme deri në fund të vitit.

## 7. AKTIVITETET E PLANIFIKUARA PËR PERIUDHEN PASUESE

- Përgatitjet për publikimet e tenderëve bazuar në planin e prokurimit;
- Monitorim i përditshmërisë së personelit për të ndikuar në shërbime shëndetësore cilësore dhe të qasshme.

## 8. TË TJERA

Shënoni çështjet tjera që mendoni se janë me rëndësi të raportohen e që nuk kanë qenë të përfshira në pikat e mësipërme.

## QENDRA E MJEKËSISË URGJENTE

### Hyrje

Qendra e Mjekësisë Urgjente në Prishtinë, gjatë muajit dhjetor 2021, ka ofruar shërbime urgjente mjekësore me autoambulanca dhe ekipe mjekësore në terren për qytetarët e Prishtinës dhe fshatrave të komunës.

### Patologjia dhe shërbimet

Nga raportimet e stafit mjekësor përmes përgjegjësve të turneve, rastet urgjente janë trajtuar në terren sipas thirrjeve dhe kategorizimit të triazhes së prioriteteve, për nga frekuenca ka dominuar:

- Hipertensioni arterial;
- Sëmundjet pulmonare opstruktive kronike (SPOK);
- Gjendjet gripoze me temperaturë të lartë;
- Aastma bronchiale;
- Abdomeni acut;
- Sindromi akut koronar;
- Intoksikacionet alimentare;
- Ataquet cerebrovasculare;
- Pneumonitë atipike, post COVID 19;
- Lëndimet nga aksidentet në trafik;
- Lëndimet aksidentale etj.

Numri i rasteve është prezentuar në raportin nga zyrtarja e SISH.

### Edukimi i vazhdueshëm profesional

Në kuadër të EVP-së, në sallën e trajnimit dhe edukimit të QMU-së, më 10. 12.2021, nga ora 9:00 -14:00, është mbajtur trajnimi:

*Mbështetja Themelore e Jetës (MTHJ), AED; BLS-D;*

*Mbështetja e Avancuar e Jetës (MAJ), ALS;*

Trajnimi është zhvilluar në QMU - Salla e trajnimit dhe edukimit, dhe nga pjesëmarrësit është vlerësuar shumë i dobishëm në aspektin profesional.

Më 17 dhjetor, në emër të QMU-së, në Qendrën e Telemjekësisë për nevojat e punonjësve shëndetësorë të të gjitha niveleve, kemi prezantuar ligjëratën:

Mbështetja Bazike e Jetës (BLS), Protokollat 2021, sipas Këshillit Evropian të Reanimacionit.

### **Situata me pandeminë COVID 19**

Nga informatat që kemi nga IKSHP, kemi një rritje të rasteve me COVID 19, të formës omikron.

Ekipet tona janë përgjigjur në thirrje, duke iu ofruar ndihmë në shtëpi dhe transport me ekip mjekësor dhe autoambulancë deri në klinikat e QKU-së, ku trajtohen rastet me COVID 19.

Gjatë muajit dhjetor, nga kolektivi nuk kemi pasur asnjë punonjës të infektuar me COVID 19.

Kemi vazhduar edhe gjatë muajit dhjetor, në 7 ditë të javës, nga ora 07:00 deri 20:00, një ekip mjekësor nga QMU-ja ka kujdestaruar në sallën "1 Tetori" për të ofruar kujdes mjekësor për të gjithë personat që kanë pasur nevojë për tretman dhe këshilla mjekësore gjatë vaksinimit.

Nga dt. 20 dhjetor, kemi vazhduar kujdestarit në Qendrën e Mjekësisë Familjare në Emshir, nga ora 08:00 deri në 19:00.

Në bazë të kërkesës së Ministrisë së Shëndetësisë -Komitetit për imunizim të popullatës me vaksinën kundër COVID-19, gjatë muajit dhjetor 2021, prej orës 12:00 deri 20:00, çdo ditë (24/7), një ekip mjekësor nga QMU-ja ka asistuar me ekipin e vaksinimit nga QKMF-ja, në qendrën tregtare "Albi Mall" në Veternik.

Duke iu përgjigjur nevojave të zgjerimit të fushatës për vaksinim, nga data 13.12.2021, çdo të dytën ditë QMU-ja ka ndihmuar fushatën e vaksinimit me një autoambulancë dhe një infermier vozitës në Aeroportin Ndërkombëtar "Adem Jashari".

Gjatë muajit dhjetor, ka vazhduar fushata e vaksinimit vullnetar pa asnjë lloj procedure administrative.

Ekipet mjekësore kanë intervenuar për çdo nevojë ose shqetësim të qytetarëve, dhe fatmirësisht deri tani nuk kemi pasur raste të rënda të komplikimeve postvaksinale.

Nga ekipet mjekësore deri tani, janë raportuar raste për këshilla ose ndonjë ekzaminim, si matje të tensionit arterial, pulsit, saturimit të oksigjenit, matjes së sheqerit për personat me sëmundje kronike etj.

**RAPORTI I SHËRBIMEVE PËR MUAJIN DHJETOR I KORDINATORËS  
SË SISH-SË**

Nr.	Lloji i shërbimit	Nr.
1	Vizita mjekësore në terren	1372
2	Vizita mjekësore në QMU	10
3	Kirurgji e vogël	7
4	Aksidente trafiku	111
5	Fatkeqësi të tjera	69
6	Reanimime	10
7	EKG	20
8	Transporte	343
9	Konstatim vdekjeje	76
10	Gjithsej	2082

**ZYRA E PROKURIMIT NË QMU**

❖ **AKTIVITETET E PLANIFIKUARA:**

- Zhvillimi i aktiviteteve të procedurave të prokurimit sipas prioriteteve dhe kërkesave nga njësitë kërkuese;
- Bashkëpunimi i Zyrës së prokurimit për kontratat e lidhura në komunë dhe bashkëpunimi sipas UA/2016 të LPP me AQP për kyçe në kontratat e centralizuara;
- Sipas LPB-së, bashkëpunimi me drejtorin e QMU-së për caktimin e komisioneve dhe punimin e vendimeve, nënshkrimi, protokollimi për vlerësimin e ofertave, pranim të mallrave, shërbimeve, caktimin e menaxhereve të kontratave etj., sipas nevojave të paraqitura.

❖ **AKTIVITETET E ZBATUARA**

- Nxjerrja e urdhërblereve në sistemin FREE BALANC për të gjitha faturat për kontratat që lidhen në QMU dhe faturat e kontratave të AQP-së të cilat i shfrytëzon QMU;
- Vlerësimi i ofertave për furnizim me material shpenzues shëndetësor në QMU;
- Njoftimi për dhënie kontrate, nënshkrimi i kontratës;
- Caktimi i komisionit për pranim të mallit dhe pranimi i raportit nga komisioni, fatura, flete dërgesa , konstatimit dhe përgatitja e lëndës për pagesë;

- Pranimi i kërkesës dhe dokumentet tjera përcjellës për fillimin e procedurës për kontrollimin dhe mbushjen e aparateve të zjarrit;
- Punimi i DT në platformën e E-prokurimit;
- Hapja dhe vlerësimi në procedurë;
- Lidhja e kontratës, njoftimi për nënshkrim kontrate në E-prokurim;
- Kompletimi i lëndës dhe përgatitja e saj për pagesë.

❖ **AKTIVITETET NË ZBATIM E SIPËR**

- ❖ Takime me palë të ndryshme, kompletimi i lëndëve për pagesa dhe aktivitete tjera sipas nevojës;
- ❖ Përgatitja e raportit për kontratat e nënshkruara për vitin 2021;
- ❖ Mbledhja e kërkesave nga njësitë kërkuese për punimin e Planifikimit përfundimtar të prokurimit dhe dorëzimi i tij përmes platforme në AQP.

**ZYRA E FINANCAVE NË QMU**

❖ **AKTIVITETET E PLANIFIKUARA**

- Mbajtja e një takimi me stafin udhëheqës në lidhje me punët e kryera gjatë vitit 2021 dhe shpenzimeve të krijuara, si dhe detyrat që na presin për vitin 2022.

**AKTIVITETE TË PËRFUNDUARA:**

- Përgatitja e lëndëve të poshtëshënuara për pagesë dhe fotokopjimi i tyre;
- Shpenzimet e telefonit për muajin nëntor;
- Shpenzimet e tel. në ambulancën në rr “Xhemajl Ibishi” për muajin nëntor 2021;
- Mbushje telefonike për punëtorë për muajin nëntor;
- Furnizim me ujë për pije për muajin nëntor;
- Shfrytëzimi i automjetit me qira për muajin nëntor;
- Furnizim me karburante për muajin nëntor;
- Përcjellja e pagave me ndryshime – pushime të lehonisë, largime nga puna etj. për muajin dhjetor;
- Përgatitja e pagave për 3 punëtorët me kontrata për punë specifike për muajin nëntor;
  - Kontrollimi i të gjitha pagesave që të kryhen dhe mos të mbesin obligim për vitin 2022;
  - Barazimi i faturave me furnizues dhe ata që kanë kryer shërbime.

❖ **AKTIVITETE NË ZBATIM E SIPËR**

- Faturat të cilat duhet të përgatiten për pagesë;

- Fatura e rrymës;
- Sigurimi i autoambulancave;
- Mirëmbajtja e fotokopjes me qira e printerëve;
- Mbushje telefonike për punëtorë;
- Përgatitja e ndërrimeve të natës;
- Përgatitja e faturave komunal (rrymë, ngrohje, PTK) të cilat janë të rregullta, së bashku me faturat e karburanteve dhe automjetit me qira, si dhe pagesat dhe shërbimet tjera.

Kontrollimi i arkës dhe mbarëvajtja e parasë së imët.

Faturat e lartcekura janë të rregullta, çdo muaj, dhe duhet të përgatiten me të gjitha dokumentet përcjellëse dhe të dërgohen në DSH.

## **QENDRA KRYESORE E MJEKËSISË FAMILJARE**

### **RRJEDHA E PUNËS**

Ka vazhduar organizimi i brendshëm i përshtatur me situatën epidemiologjike, për ofrimin e shërbimeve shëndetësore:

- Tri Qendra të Mjekësisë Familjare (QKMF, QMF IV dhe QMF V) kanë vazhduar punën pa ndërprerje (24/7) në ndërrime të zakonshme (07:00 - 13:30; 13:30 - 20:00 dhe 19:00 - 07:00);
- Të gjitha Qendrat e Mjekësisë Familjare punojnë me orar të rregullt (07:00-13:30,13:30-20:00);
- Të gjitha Qendrat e Mjekësisë Familjare kujdestaria e rregullt mujore, e shtune(07:00-19:00) dhe e diele (07:00-13:00);
- Kujdestaria festive organizohet në QKMF,QMF II,QMF IV,QMF V dhe QMF VI.

Procesi i vaksinimit sipas planit të veprimt, është zhvendosur nga salla "1 Tetori" në Qendrën e Vaksinimit në QMF 7 – Kalabri në Prishtinë, nga data 20.12.21, me aplikimin e dozës së parë, të dytë, të tretë dhe dozë përforcuese me vaksinën kundër COVID 19 dhe vaksinën kundër gripit sezonal. Në shërbim janë 14 ekipe.

Punohet çdo ditë të javës nga ora 07:00-15:00;

- Nga data 13.12.21 testet Rapide antigjen për qytetarët e Prishtinës ofrohen në AMF Qendra e Studentëve, çdo ditë të javës, me orar 08:00-15:30;
- Janë punuar 621 teste rapide antigjenike;
- Analiza e D-Dimerit në QKMF, janë punuar 327;
- 21 pacientë të testuar me teste serologjik.



Numri i konsultave virtuale gjatë muajit dhjetor ka arritur në 178 konsulta.

- Poliklinika e Stomatologjisë dhe Shërbimi stomatologjik, orari i punës (07:00-15:00), Shërbimi i stomatologjisë në QMF 5 punon 24/7;

- Shërbimi Pediatrik, orari i punës (07:00-13:30 dhe 13:30-20:00).

- QMG orari i punës (07:00-15:00).

- Shërbimi Specialistik, orari i punës (07:00-15:00).

- Mjekësia e punës, orari i punës (07:00-15:00).

- DAT orari i punës (07:00-13:00).

- Laboratori qendror, orari i punës (07:00-14:00 -13:00-20:00).

- Radiologjia, orari i punës (07:00-13:00), në funksion për momentin janë dy njësi radiologjike në QKMF, QMF V. Gjatë muajit dhjetor 2021 janë realizuar : Mamografi 89, Echo e gjinjve 62, Echo e Abdomenit 171.

- Shërbimi kronik punon me orar të rregullt (07:00-19:00) çdo ditë pune, nuk punohet vikendeve dhe ditëve festive. Puna organizohet me dy ndërrime, paradite dhe pasdite me nga një ekip (një mjek dhe një infermiere).

- Shërbimi i Vaksinit nga data 20.12.2021 kthehet me orar të rregullt 07:00-20:00 ndërsa nga data 25.12.2021 kthehet edhe kujdestaria e rregullt 12 orëshe, e shtune 07:00-19:00.

AMF të ( punon çdo ditë pune nga ora 07:00-14:00, mjeku dhe infermieri Shkabaj, Mramor, Bardhosh, Lukar, Barilevë ).

- Keqekollë punon tre ditë në javë ( e hënë, e mërkurë, e premte );

- Koliq ( të martën mjeku, ndërsa infermieri çdo ditë);

- Dabishevc ( e enjte, ekipi komplet );

- Viti Bullaj nuk punon për momentin;

- Slivovë ( e marte dhe e enjte mjeku punon ndërsa infermieri çdo ditë);

- Sharban, Rimanishtë, Kishnicë ( infermieri çdo ditë dhe higjienisti).

- Numri i stafit të infektuar, gjatë muajit dhjetor nuk kemi asnjë punëtor shëndetësor të infektuar.

Gjatë vizitave monitoruese në të gjitha Qendrat e Mjekësisë Familjare (ndërrimi i paraditës, pasditës dhe ndërrimi i natës), nuk janë konstatuar mangësi serioze.

- Respektohen rregullat e përgjithshme, furnizimi qëndron mirë, masat mbrojtëse aplikohen.

Vizita mjekësore	Shërbimet shëndetësore	Shërbimet laboratorike	Shërbimet stomatologjike	Shërbimet radiologjike	Gjithsej
83266	79257	70003	1827	2469	231306

### **NGA: Poliklinika Stomatologjike**

**Më 22.12.2021**

Numri i pacienteve në Shërbimin stomatologjik të QKMF Prishtine: 3512;

Numri me participim 484;

Të hyra 1125.00 euro;

Shërbimi i rëntgenit në Poliklinikën stomatologjike QKMF;

Numri i grafive 300, numri me participim 87;

Te hyra gjithsej 130.50 euro;

19 punëtorë në pushim mjekësor, 4 punëtorë pushim të lindjes, 2 punëtorë me orar të shkurtuar për gjidhënie;

Një vizitë në QMF 5 me të gjithë stafin, një vizitë ne QMF Vneshtat;

Mirëmbajtja e pajisjeve të rëntgenit;

Planifikimi i nevojave nga lista esenciale;

Planifikimi i nevojave për vitin 2022.